



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË**

PROJEKT - VENDIM

Datë ____ . ____ . 2025

**“PËR SHPREHJEN NË PARIM PËR PËRCAKTIMIN E VENDBAZIMEVE TË
MJETEVE LUNDRUESE DHE KORRIDORET E LËVIZJES SË TYRE NË ZONËN E
PLAZHIT, PËR SEZONIN TURISTIK 2026”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja (b), nënpika 1.2 shkronja “c”, nenit 18 pika 2, nenit 23, pika 6, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55 pika 4, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, të Vendimit nr. 649, datë 16.10.2024, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” I ndryshuar, të VKM-së nr. 845, datë 28.10.2020 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e aktiviteteve turistike detare, që kryhen nëpërmjet mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi”, VKM-së nr. 321, datë 28.05.2014 “Për sigurinë në dete e plazhe, në ujrat e brendshme në thellësi të territorit gjatë ushtrimit të sporteve ujore”, Kryetari i Bashkisë Kavajë i propozon Këshillit Bashkiak që në mbledhjen e tij të rradhës:

TË VENDOSI:

1. Miratimin në parim të përcaktimit të vendbazimeve të mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre në zonën e plazhit, për sezonin turistik 2026.
2. Ngarkohet Drejtoria e Kadastrës Urbane, Menaxhimit të Aseteve Publike, Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative, Drejtoria e Burimeve Ekonomike për zbatimin e këtij projekt-vendimi.
3. Një kopje e vendimit ti dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme Detare (Drejtorisë së Policisë Kufitare Durrës)
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Tiranë.

Drejtorja e Kadastrës Urbane, Menaxhimit të Aseteve Publike
Izmir Proshka

Drejtorja e Planifikimit Zhvillimit të territorit dhe Menaxhimit të Kontratave
Dëshira Qato

Drejtorja Ligjore
Helidon Plaku

Sekretare e Këshillit Bashkiak
Meri Biturku

KRYETAR I BASHKISË
FISNIK QOSJA

Sehrelan
Adnan
Mëlan



RELACION

“PËR SHPREHJEN NË PARIM PËR PËRCAKTIMIN E VENDBAZIMEVE TË MJETEVE LUNDRUESE DHE KORRIDORET E LËVIZJES SË TYRE NË ZONËN E PLAZHIT, PËR SEZONIN TURISTIK 2026”

Në zbatim të kompetencave që i jep Bashkisë Kavajë legjislacioni në fuqi dhe në veçanti VKM nr. 649 datë datë 16.10.2024, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” i ndryshuar paraqitet ky projekt-vendim për përcaktimin e vendbazimeve të mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre në zonën e plazhit, për sezonin turistik 2026”, i cili synon të formalizojë dhe të standartizojë përdorimin e hapësirës ujore në territorin e bashkisë.

Ky projekt-vendim paraqitet për miratim në Këshillillin Bashkiak Kavajë me qëllim:

- të përcaktimit të vendbazimeve (vendqëndrimeve) të mjeteve lundruese në zonën e plazheve të administruara nga Bashkia Kavajë
- përcaktimin e korridoreve të detyrueshme të hyrje-daljeve të mjeteve lundruese, të cilat sigurojnë lëvizje të rregullt dhe të sigurt për pushuesit;
- krijimin e një kuadri lokal zbatues në përputhje me VKM nr 649 datë datë 16.10.2024, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” i ndryshuar dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.

Gjatë sezonit turistik, nën zonën bregdetare të Bashkisë Kavajë evidentohet rritje e fluksit të mjeteve lundruese, gjë që krijon rreziqe të shtuara për pushuesit në mungesë të korridoreve të qarta dhe vendbazimeve të autorizuar. Kërkohet rritja e sigurisë dhe parandalimi i aksidenteve për shkak të fluksit të mjeteve lundruese, si dhe administrim më i mirë i vijës bregdetare.

Për këtë arsye, përcaktimi paraprak i vendbazimeve dhe korridoreve të lëvizjes është një domosdoshmëri për:

- Ngritjen e standardeve të sigurisë;
- Parandalimin e aksidenteve;
- Administrimin më efikas të vijës bregdetare;
- Orientimin e subjekteve private që ofrojnë mjete lundruese me qira;
- Përmbushjen e kërkesave që përcakton kuadri ligjor për sezonin turistik.

Referuar VKM-së nr. 649 datë datë 16.10.2024, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” i ndryshuar, bashkia ka kompetencë të miratojë vendqëndrime të mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre si dhe të bashkëpunojnë me Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe me strukturat e Policisë Kufitare.

Kjo ndërhyrje krijon një sistem të qartë, të dokumentuar dhe të detyrueshëm për të gjitha subjektet operuese.

Ky projekt-vendim përcakton numrim të vendbazimeve, pozicionin dhe koordinatat e çdo vendbazimi për mjetet lundruese, sipas hartës bashkëlidhur duke sjellë detyrimin për subjektet:

- Të përdorin vetëm vendbazimet e miratuara
- Të respektojnë korridoret e lëvizjes së tyre
- Të vendosin sinjalistikë të dukshme
- Të marrin masa sigurie për pushuesit

Vendbazimet e mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre të përcaktuara nga Bashkia Kavajë për sezonin turistik 2026 si dhe elementet e nevojshëm lidhur me standartet e

kërkuara nga aktet ligjore në fuqi, sipas dokumentacionit hartografik bashkëlidhur, janë me koordinata si më poshtë:

1. E: 458594.37	N:4565193.20
2. E: 459368.59	N: 4567003.45
3. E: 459690.96	N: 456894.33
4. E: 459702.63	N: 4569411.94
5. E: 456345.996	N:4561136.550
6. E: 455941.788	N:4560844.159
7. E:459659.114	N:4568443.233
8. E:459645.35	N:4568263.78
9. E:459035.11	N:4566249.28

Miratimi i këtij projekt-vendimi është një hap i domosdoshëm për menaxhimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të zonës bregdetare të Bashkisë Kavajë dhe sjell:

- vendosjen e kriterëve të qarta,
- rrit sigurinë në plazh dhe ul rreziqet për pushuesit,
- rregullon dhe formalizon aktivitetet e mjeteve lundruese,
- përmirëson cilësinë e e shërbimit turistik
- mundësi më e mirë për kontroll dhe inspektim nga bashkia dhe institucionet e tjera përgjegjëse.

Për sa më sipër, propozohet që Këshilli Bashkiak Kavajë të miratojë projekt-vendimin:


“Për shprehjen në parim për përcaktimin e vendbazimeve të mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre në zonën e plazhit, për sezonin turistik 2026”


Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!


**Drejtoria e Kadastrës Urbane, Menaxhimit të Aseteve Publike
Izmir Proshka**
















SECRETARIA
DIA KAVAJE



BAKIR KAVAJE-33



SE-3/AJE
KIA KAWAJE





RISE-
KAVAJE



